



SHDPAK
FONDACIONI
SHQIPTAR
PËR TË DREJTAT
E PERSONAVE
ME AFTËSI
TË KUFIZUARA

FONDACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Raport Vjetor 2006



Annual Report 2006

ALBANIAN DISABILITY RIGHTS FOUNDATION



Përshëndetje

Në cilësinë e Drejtueses Ekzekutive të FSHDPAK, kam kënaqësinë të prezantoj raportin e aktivitetit të kësaj organizate gjatë vitit 2006.

Ky botim është një përmbledhje e shkurtër e disa prej aktiviteteve dhe arritjeve kryesore të FSHDPAK.

Raporti pasqyron progresin dhe rezultatet e arritura në bashkëpunim me partnerët dhe bashkëpunëtorët e FSHDPAK në të gjitha nivelet.

Do të doja të theksoja se viti 2006 ka qenë një vit përpjekjesh, arritjesh pozitive në drejtim të mbrojtjes të së drejtave, përmirësimit të cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri.

Do të doja të përshëndesja përpjekjet dhe përkushtimin e të gjithë ekipit të FSHDPAK në realizimin me sukses të objektivave tona për 2006.

Blerta ÇANI
Drejtoresh Ekzekutive

Permbajtja

Përschendetje	1
I. Aprovohet “Konventa Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”	2
II. Programet e FSHDPAK per vitin 2006	4
• Qendra Burimore e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar	4
• Shërbime mbështetëse për njerëzit me aftësi të kufizuar në nevoje për karrige me rrota ne Shqipëri	14
• Asistence ligjore dhe avokat falas për PAK dhe familjaret e tyre	23
• Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në proceset elektorale dhe politike	28
• Konventa per te drejtat e personave me aftesi te kufizuar	30
• Ndërtimi i një programi zhvillimi për një komunitet gjithëpërfshirës (BIDC)	31
III. Informacion financiar	34
IV. Raporti i auditimit	35
V. Planifikimi strategjik i FSHDPAK 2006-2009	36
VI. Publikime të FSHDPAK, 2006	40

I.

Aprovohet ne 13 Dhjetor 2006 në New York nga Asambleja e Pergjithshme e Kombeve te Bashkuara “Konventa Ndërkombëtare per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar”

Konventa Ndërkombëtare për te Drejtat e Personave me Aftësi te Kufizuar u aprovua ne 13 Dhjetor 2006, ne New York nga Asambleja e Pergjithshme e Kombeve te Bashkuara. Miratimi i Konventës përfaqëson një ngjarje historike per personat me aftesi te kufizuar ne mbare boten.

Konventa eshte e nje rëndësie te veçante ne jeten e personave me aftesi te kufizuar per faktin se përfaqëson dokumentin e pare ne te cilin aftësia e kufizuar njihet si Çështje e te Drejtave te Njeriut. Është hera e pare qe një instrument ndërkombëtar i këtij lloji mbulon si te drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore te njerezve me aftesi te kufizuara, duke vendosur nje kuader efektiv per mbrojtjen e te drejtave te 650 milion njerezve me aftesi te kufizuar ne bote. Vendet ratifikuese do te kene detyrimin ligjor për të garantuar në mënyrë të plotë dhe efektive të drejtat e njerezve me aftesi te kufizuar, te shprehura qarte ne 31 nenet e konventës, si për çdo individ tjetër. Procesi i aprovimit te kësaj konvente përbën ndër të tjera edhe një element shumë të rëndësishëm, sepse për here te pare, OJF e aftësisë se kufizuar nga gjithë bota kane përbëre një force shtytëse drejt aprovimit final te tekstit gjatë negociatave të mbajtura në OKB.

Fondacioni Shqiptar për te Drejtat e Personave me Aftësi te Kufizuar është përfshire qe ne fillimet e lëvizjes për hartimin e kësaj Konvente.



Si anetere e EDF (Forumit European te Aftesise se Kufizuar) dhe DPI (Organizates Nderkombetare te Personave me Aftesi te Kufizuar) si organizate e fokusuar ne fushen e te drejtave te njeriut, me fokus mbrojtjen e te drejtave te personave me aftesi te kufizuar, FSHDPAK ka marre pjese ne seminare dhe forume Europiane duke dhene opinione dhe sygjerrime konkrete mbi permbajtjen e draft konventes. FSHDPAK permes nje procesi te vazhdueshem avokatie e bashkëpunimi me Ministrine e Puneve te Jashtme dhe organizmat te tjere ka bere te mundur përfshirjen e Qeverise Shqiptare, ne procesin e hartimit te konventes si dhe me tej shprehjen e gadishmerise per firmosje dhe ratifikim.

II. Projekte të FSHDPAK 2006

QENDËR BURIMORE PËR TE DREJTAT E AFTËSISË SE KUFIZUAR

DONATOR: CORDAID
BUXHETI: 159, 440 EURO
NUMRI I PROJEKTIT: 432/10033/ A
PERIUDHA: 1 JANAR 06 – 31 DHJETOR 06

FSHDPAK vazhdon te jete një nga qendrat burimore të të drejtave te aftësisë se kufizuar me të mirë organizuara ne Shqipëri.

Gjate vitit 2006, programi është fokusuar ne përmirësimin e cilësisë se kujdesit dhe jetës, si dhe promovimin e te drejtave te personave me aftësi te kufizuar mendore dhe anëtarëve te familjeve të tyre.

Objektivat

- 1- Ndërtimi i kapaciteteve dhe dhënia e informacionit për te gjithë aktoret përgjegjës, lidhur me çështjet e personave me aftësi te kufizuara intelektuale, nëpërmjet zgjerimit te Qendrës Burimore të së Drejtave te Aftësisë se Kufizuar.
- 2- Zgjerimi i avokatisë ne nivel vendor duke realizuar një model te një procesi te zhvillimit dhe implementimit te politikave për personat me aftësi te kufizuar intelektuale nëpërmjet ngritjes se një Qendre për Zhvillimin e Shanseve te Barabarta.

- 3- Përmirësimi i statusit ligjor, social, ekonomik të personave me aftësi të kufizuara mendore nëpërmjet organizimit të monitorimit konstant, avokatisë dhe fushatave publike arsimore si dhe lobimit politik dhe/ose institucional në nivel qendror dhe vendor për çështjet që prekin të drejtat e personave me aftësi të kufizuara intelektuale.
- 4- Ndërtimi i rrjeteve dhe bashkëpunimit me OJF të prindërve, organizata të tjera për aftësinë e kufizuar, organizata të fokusuar në të drejtat e njeriut, duke i kushtuar rendësi të veçante bashkëpunimit me organizata të grave për të trajtuar dhe gjithëpërfshirë çështjet e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar intelektuale, në mënyre të veçante të drejtat e grave e vajzave.

Ndërhyrjet e realizuara në kuadrin e programit të Qendrës Burimore, kanë kontribuar në rezultate të ndjeshme:

1- Krijimi i kapaciteteve në fushën e aftësisë së kufizuar mendore nëpërmjet ofrimit të informacionit dhe trajnimeve.

- Shërbimi i informimit

Gjatë këtij viti ka pasur vëmendje të veçante për përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit. Janë përgatitur një komplet fletësh informative në fushën e aftësisë së kufizuar mendore.

- Informacion bazë se ç'është aftësia e kufizuar mendore,
- Shifra dhe fakte për aftësinë e kufizuar mendore në Shqipëri /Shkodër,
- Politika dhe legjislacioni në fushën e aftësisë së kufizuar mendore në Shqipëri,
- Arsimimi i personave me aftësi të kufizuar mendore në Shqipëri, legjislacioni, informacion praktik se si të mundësohet arsimimi i personave me aftësi të kufizuara mendore.
- Punësimi i personave me aftësi të kufizuar mendore në Shqipëri, çfarë garanton legjislacioni, informacion praktik se si të mundësohet punësimi për Personat me Aftësi të Kufizuar Mendore.



- Avokatia si një mjet i dobishëm për prindërit e personave me aftësi të kufizuara mendore
- Përfitues/përdorues të informacionit të FSHDPAK
 - 1080 persona me aftësi të kufizuara dhe familjare të tyre, përfaqësues të OJF, studente, etj, klientë të qendrës, 43 % përfituese femra.
 - Anëtare të rrjeteve të bashkëpunimit të FSHDPAK (260 rubrika), të cilët në mënyrë periodike marrin botime të qendrës burimore.
 - Përdorues/ klientë të zyrës për shanse të barabarta, program i FSHDPAK në Shkodër, si dhe të përfitues të programit ligjor që FSHDPAK ofron në Durrës, Elbasan, Korçë dhe Vlorë.
 - Përdorues të faqes së internetit të FSHDPAK.

- Veprimtari trajnuese

Një sere sesionesh trajnuese të planifikuara në aktivitetet e projektit, janë organizuar nga Qendra Burimore e FSHDPAK në 2006 kryesisht në qytetin e Tiranës dhe Shkodrës me objekt strukturat përgjegjëse qeveritare në nivel qendror e vendor, shoqërië civile, organizatat e prindërve, etj.

FSHDPAK organizoi një trajnim për trajnerë me synim kryesor zgjerimin e njohurive të trajnerëve veçanërisht në fushën e aftësisë së kufizuara mendore.

15 sesione trajnimi u organizuan gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2006, me fokus kryesor të drejtat e njeriut, të drejtat e aftësisë së kufizuara dhe legjislacioni që lidhet me personat me aftësi të kufizuara intelektuale/mendore.

Temat e trajnimit	Përfituesit	Numri i trajnimeve	Numri i përfituesve	Rrethi zona
E drejta për arsim e fëmijëve me aftësi të kufizuar mendore.	Përfaqësues te pushtetit lokal dhe institucioneve publike ne fushën e arsimit.	2	39	Tiranë, Shkodër
E drejta për punësim e personave me aftësi te kufizuar mendore	Nëpunës përgjegjës te qeverisjes vendore, komuniteti i biznesit, etj.	2	32	Tiranë, Shkodër
Ofrimi i shërbimeve sociale për personave me aftësi te kufizuar mendore	Nëpunës përgjegjës për shërbimet sociale ne zyrën rajonale, bashki, drejtoret e shërbime shoqërore publike (qendrat ditore dhe rezidenciale, shtëpitë për te moshuarit, jetimoret, etj.).	2	28	Tiranë, Shkodër
Te drejtat e aftësisë se kufizuar dhe legjisllacioni/Rrjetet dhe avokatia	Organizatet e prindërve	7	59	Tiranë, Shkodër
Te drejtat e aftësisë se kufizuar dhe legjisllacioni, modele te ofrimit te shërbimeve sociale ne komunitet	Ofrues te shërbimeve sociale	1	18	Tiranë, Shkodër
Te drejtat e aftësisë se kufizuar dhe legjisllacioni, praktika e arsimit gjithëpërfshirës	Mësuesit e përfshirë në arsimin gjithëpërfshirës	1	20	Shkodër
TOTALI		15	196	2 rrethe

Procesi i vlerësimit te trajnimeve nga pjesëmarrësit evidentoi mungesën e informacionit te mjaftueshëm dhe ekspertizë në këtë fushë, ata e konsideruan si vërtet të rëndësishëm bashkëpunimin dhe investimin ne ndërtimin e kapaciteteve. Trajnimet e organizuara kanë kontribuar ne një mase te madhe për stimulimin e rrjeteve dhe koordinimin.

Me synim fuqizimin e prindërve dhe familjareve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të bërë të mundur aftësimin e tyre si avokate të drejtave që legjislacioni garanton për ta, gjatë vitit 2006, FSHDPAK në bashkëpunim me ndihmën financiare të GTZ realizoi një cikël trajnimesh me prinder dhe familjare të femijeve me aftësi të kufizuara në Tiranë, Korçë dhe Shkoder. Trajnimet u fokusuan në fusha si:

- “Njohuri mbi aftësinë e kufizuar, të sfidohen perceptimet mbi aftësinë e kufizuar,” trajnim që synonte aftësimin e pjesëmarrësve përmes ofrimit të një informacioni baze mbi aftësinë e kufizuar, dhe shmangien e paragjytimeve dhe stereotipeve të krijuara në këto fusha.
- “Të drejtat dhe legjislacioni në fushën e aftësisë së kufizuar / avokati dhe lobim” me qëllim njohjen me deklaratat, rregullat, politikat dhe legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e aftësisë së kufizuar, si dhe aftësimin e pjesëmarrësve për të qenë avokatet me të mirë në mbrojtje të drejtave të femijeve të tyre.

Veç trajnimit, pjesëmarrësve ju ofruan botime të FSHDPAK, përfshirë pakete informative për prinderit në ndihmë të procesit të mirërritjes së femijeve me aftësi të kufizuara, pakete përmbledhëse e legjislacionit në fushën e aftësisë së kufizuar, revista e përtremuajshme Sfida- botim i FSHDPAK, guida shjeguëse të ligjeve të vecanta etj. 54 prinder dhe familjare të femijeve me AK, morën pjesë aktive në trajnimet e organizuara.

Një nga konkluzionet e vlerësimit të trajnimeve ishte domosdoshmëria për trajnime, shkëmbim eksperiencash të prindërve, por njëkohësisht shtrirja e këtij procesi dhe në nivelin e administratës shtetërore, pushtetit vendor, ofruesve të shërbimeve publike e private.

Po si e domosdoshme evidentohet nevoja për ndërgjegjësim të komunitetit të gjërë, në mënyrë që të shmangen qëndrimet dhe praktikat diskriminuese dhe përjashtuese që ende mbizoterojnë në shoqëri shqiptare.





2- Krijimi i një Qendre për Zhvillimin e Shanseve të Barabarta për personat me aftësi të kufizuara mendore në qytetin e Shkodrës

Që nga janari 2006, është krijuar dhe vazhdon të funksionojë në Shkodër një qendër për ofrimin e shanseve të barabarta. Aktiviteti i Qendrës për Zhvillimin e Shanseve të Barabarta në Shkodër fokusohet në mbështetjen për personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe familjet e tyre përmes shërbimeve të informacionit, trajnimit, orientimit, mbështetjes ligjore. Ajo ka eksploruar dhe ka dhënë shanse konkrete për arsimim, trajnim profesional dhe punësim të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara në Shkodër.

Arritje të shërbimeve të ofruara nga qendra për vitin 2006

- 300 personat me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre kanë marrë informacion, mbështetje, ndihmë ligjore falas dhe orientim në fusha si të drejtat e dhe legjislacioni, shërbimet sociale, arsimit, punësimi, etj.
- Një nga përparësitë themelore të qendrës është integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore në shkollat e qytetit. 11 fëmijë me aftësi të kufizuara u vlerësuan dhe në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë Arsimore të Shkodrës, u integruan në shkollat e zakonshme. U është dhënë mbështetje e vazhdueshme 36 fëmijëve të integruar me aftësi të kufizuara në shkollat, në fusha ku ka qenë evidente mungesa e mbështetjes për mësuesit, bashkëmoshatarët, dhe prindërit e tyre. Nga ana tjetër përpjekjet e avokatisë me drejtorinë përkatëse arsimore,

ka synuar realizimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe garantimin e qëndrueshmërisë së tij në praktikë.

- Ndërtimi i kapaciteteve të aktoreve kryesore përgjegjës për të siguruar arsimimin, aksesin në shërbimet sociale, punësimin dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara mendore në komunitet nëpërmjet kontakteve, shkëmbimit të informacionit dhe trajnimit.
- Krijimi i rrjetit të prindërve. Është identifikuar në bashkëpunim me shoqatën e prindërve, shkollat speciale dhe institucionet e tjera publike dhe private, një grup i prindërve aktivë i përbërë nga 10 prindër i cili përmes mbështetjes dhe trajnimit ka krijuar një rrjet të fortë prindërisht në nivel vendor në qytetin e Shkodrës.
- Qendra për zhvillimin e shanseve të barabarta në Shkodër, nuk ka krijuar thjesht rrjete të veçanta për çështje specifike por është përpjekur të bashkërendojë dhe të organizojë aktivitete të përbashkëta. Një nga këto aktivitete ishte seminari i organizuar në korrik 2006, i cili krijoi një dialog mes të gjithë aktorëve, institucioneve të qeverisjes vendore, shoqërisë civile dhe medias, duke synuar përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara. Dialogu i vendosur në këtë seminar ka qenë konsistent gjatë gjithë vitit.



3- Është mbështetur dhe organizuar avokati dhe lobim në nivel qendror dhe vendor për përmirësim të statusit ligjor, social, ekonomik të personave me aftësi të kufizuara mendore.

- FSHDPAK inicioji një lëvizje avokatie në fushën e aftësisë së kufizuara mendore, duke grupuar të gjitha organizatat aktive të prindërve (8), me të cilat bazuar në një memorandum mirëkuptimi, u punua intensivisht gjatë gjithë vitit 2006.

Përpjekjet e avokatisë dhe fushata e këtij grupi prindërisht u përqendruan në stimulimin e implementimit të ligjit për “Ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale”, një nga ligjet kryesore që mbështet kategorinë e personave me aftësi të kufizuara mendore (intelektuale) në Shqipëri, duke përdorur strategji të ndryshme:

- Ofrimin e kontributit, ekspertizës dhe rekomandimeve në procesin e hartimit të vendimeve të domosdoshme të Këshillit të Ministrave, që do ta bënte këtë ligj të zbatueshëm.
- Ndikim në përfshirjen e organizatave të prindërve në proceset e konsultimit për vendimet e marra në fushën e aftësisë së kufizuara mendore.
- Organizimi i veprimtarive të avokatisë si: hartimi dhe qarkullimi i një deklarate për shtyp për implementimin e ligjit për ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale tek Qeveria Shqiptare, deputetët, zyrtarët e qeverisjes vendore, institucionet publike dhe private, organizata të tjera të aftësisë së kufizuara, organizatat jofitimprurëse të fokusuar në të drejtat e njeriut, gratë dhe fëmijët, organizatat ndërkombëtare, etj; organizimi i një konferencë për shtyp, në fillim të shtatorit 2006, ku në mënyrë publike ky grup i organizuar u bëri me dije shqetësimet e tij institucioneve përgjegjëse qeveritare. Përveç mbulimit në media, FSHDPAK qarkulloi një tjetër deklaratë për shtyp; një letër zyrtare, ju paraqiti Ministrin të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, Kryetares së Parlamentit, Komisioneve Përgjegjëse të Kuvendit Shqiptar.

Përpjekjet e vazhdueshme të avokatisë ndikuan që në tetor 2006, MPC&SHB të fillojë implementimin e ligjit të lartpërmendur; u miratuan 6 Vendime të Këshillit të Ministrave që patën efekt në:

- rritjen e pagesës individuale të aftësisë së kufizuara nga 6.800 leke (55 Euro) në 8.000 leke (65 Euro) në muaj;
- uljen e disa kufizimeve ligjore që mundësonin rritjen e numrit të PAK që mund të përfitonin edhe shërbimin e kujdestarit (vetëm në para meqenëse ende nuk ka një shërbim të ngritur të kujdestarit/asistentit);
- rritjen e numrit të PAK që mund të përfitonin pagesë të aftësisë së kufizuara (shifrat zyrtare japin një numër prej 10,000 persona me aftësi të kufizuara që bëheshin pjesë e skemës së aftësisë së kufizuara, pas përjashtimit të kufizimit të moshës.)
- ngritjen e një grupi ekspertësh me detyrën për të reformuar dhe miratuar standardet/kriteret e reja të vlerësimit, që Komisioni për Vlerësimin e Aftësisë për Punë duhet të ndiqte me fokus të veçantë për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (ky ishte një nga rekomandimet kryesore që grupi i ekspertëve të FSHDPAK kishte theksuar);



- filloi mbledhja e të dhënave statistikore për personat me aftësi të kufizuar
- u përgatitën standarde specifike për personat me aftësi të kufizuar në qendrat ditore dhe rezidenciale (FSHDPAK ishte anëtar i grupit të punës) të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave në Dhjetor 2006.
- Monitorimi i respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar mendore përbente një tjetër përqsasje të përpjekjeve të FSHDPAK për nxitjen e përmirësimit të statusit të personave me aftësi të kufizuara mendore.

Në vitin 2006 FSHDPAK realizoi një vlerësim që u pasua nga një raport i publikuar për respektimin e të drejtave të njeriut dhe standardet e dhënies së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar mendore.

Konstatimet e monitorimit tregojnë se akoma ekzistojnë rregullore dhe praktika diskriminues. Ka pak shërbime sociale dhe shumë pak persona me aftësi të kufizuar kanë akses në to. Akoma nuk ka standarde të mira në ofrimin e shërbimeve. Fëmijët me aftësi të kufizuar në raste të rralla kanë akses për arsimin, kryesisht në mjedise shkollore të veçuara. Shkalla e papunësisë së personave me aftësi të kufizuar intelektuale arrin afërsisht 100%. Ka shumë pak praktika pozitive që ofrohen nga shumë pak grupe të aftësisë së kufizuar. Këto dhe konstatime të tjera së bashku me rekomandime shumë të vlefshme disponohen në shqip dhe anglisht dhe do të bëhen të ditura në Konferencën Kombëtare, e para e këtij lloji për Aftësinë e Kufizuar Intelektuale në Shqipëri.

- Një drejtim tjetër ku FSHDPAK ka punuar për nxitjen e respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar mendore, ishte fushata për ndërgjegjësim të publikut.

- 3 debate publikë në kanalet televizive në 3 qytetet Elbasan, Durrës dhe Shkodër, synonin të sillnin në vëmendje të të gjithë aktorëve rajonalë detyrat dhe detyrimet që Ligji parashikon për personat me aftësi të kufizuar, dhe ajo që është më e rëndësishme implementimin e ligjit në praktikë.
- Në Mars 2006 FSHDPAK organizoi “Një Ditë për Konventën”, fokusuar në Konventën e OKB-se për te drejtat e personave me aftësi të kufizuar, një instrument i rëndësishëm ligjor miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara/ OKB në Dhjetor 2006. Vec ndërgjegjësimit të pjesëmarrësve, përfaqësuesve të qeverisë Shqiptare, OJF-ve të AK, organizatave të të drejtave të njeriut dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile, përmes përgatitjes dhe qarkullimit të një deklarate për shtyp u synua një ndërgjegjësim me i gjere për këtë moment shume të rëndësishëm dhe historik për personat me aftësi të kufizuar.
- FSHDPAK ka qene e pranishme ne media nëpërmjet kronikave ose intervistave ne kanale te ndryshëm private ose publikë, si Klan, TVSH, Top Channel, Vizion Plus, etj.
- Është e vështirë të numërohen përfituesit si rezultat i fushatave ndërgjegjësuere dhe të avokatisë. Nëpërmjet programeve televizive, kronikave, dhe reklamave si dhe botimeve të FSHDPAK, si revista tremujore “Sfida” që botohet dhe shpërndahet në 1000 kopje, FSHDPAK arrin me tepër se 1/3 popullsisë në Shqipëri.



SHËRBIME MBËSHTETËSE PËR NJERËZIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË NEVOJË PËR KARRIGE ME RROTA NË SHQIPËRI

DONATOR: USAID
BUXHETI: 118, 828 \$

Projekti i FSHDPAK mbështetur nga USAID që prej shtatorit 2004, synon të përmirësojë jetën dhe mirëqenien e Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK) në Shqipëri përmes ofrimit të shanseve për integrim dhe gjithëpërfshirje duke siguruar karrige me rrota, punësim dhe shërbime të tjera mbështetëse.

Ne shtator 2006 u bë një modifikim në grantin e FSHDPAK, duke miratuar financim shtesë për fondin aktual për të mbështetur një iniciativë tjetër të FSHDPAK, fokusuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave njerëzore të PAK, përmes ndikimit në përmirësimin dhe implementimin e politikës së aftësisë së kufizuar dhe kuadrit ligjor duke zhvilluar një instrument për monitorimin e tyre konstant.

FSHDPAK ka përdorur si mjet çuarjen përpara të idesë së Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar (SKPAK). Duke qenë të ndërgjegjshëm se miratimi i SKPAK me vendim të Këshillit të Ministrave në Janar 2005, ishte vetëm hapi i parë, FSHDPAK synon nëpërmjet këtij projekti të stimulojë implementimin e strategjisë nga agjencitë përgjegjëse.

Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuar ne nevojë për karrige me rrota

Objektivat

- Ofrimi i shanseve për integrim, për përdoruesit e mjeteve lëvizëse përmes ofrimit të karrigeve me rrota dhe mjeteve të tjera lëvizëse (kapaciteti 30 karrige ne muaj).
- Ofrimi i shanseve të punësimit për 6 persona me aftësi të kufizuar, që do prodhojnë mjete lëvizëse por që do të bëjnë edhe avokati për të drejtat e tyre, si një shembull i aftësive dhe integritetit të PAK në jetën ekonomike të komunitetit.
- Dhënia e trajnimit, arsimimit dhe mbështetjes me synim maksimalizimin e pavarësisë, mirëqenies fizike dhe potencialit për zhvillim personal të personave me aftësi të kufizuar që përdorin mjete lëvizëse.
- Rritja e kapaciteteve të PAK, pjesëtarëve të familjeve të tyre dhe kujdestareve me synim rritjen e vetëvlerësimit, cilësisë së kujdesit dhe dhënies së shërbimeve, por dhe fuqizimit të tyre në përpjekjet e tyre për të bërë avokatinë e të drejtave të tyre.
- Përmirësimi i qëndrimeve të shoqërisë në lidhje me problemet e personave me aftësi të kufizuar, kryesisht përmes medias, fletëve informative dhe shpërndarjes së botimeve, ditëve të informacionit dhe aktiviteteve të tjera ndergjegjëse për aftësinë e kufizuar.
- Lobim efektiv për të përfshirë kryesisht qeverinë dhe institucionet përkatëse, komunitetin e biznesit dhe komunitetin me gjere për të kontribuar në ofrimin e mjeteve lëvizëse për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri. Avokatia do të ketë për objektiv gjithashtu shmangien e barrierave drejt shanseve me të mëdha për arsim, punësim, etj.



Impakte themelore te projektit arritur përmes aktiviteteve ne zbatim te objektivave:

- Numri i karrigeve me rrota te prodhuara në Punishten “Mirësia” me mbështetjen e USAID nga tetor 2004 deri me shtator 2007 është 468. Granti ka mbështetur subvencionimin e prodhimit të 13 karrigeve me rrota ne muaj . (kapaciteti i plote prodhues i punishtes Mirësia është 30 karrige në muaj).

TABELA E PËRFITUESVE

Mbështetur nga USAID gjatë vitit 2006		
Përfitues	Karrige me rrota te prodhuara me mbështetjen e USAID	%
Femra	80	51.2%
Meshkuj	76	48.8%
Total	156	
Te rritur	120	76.9%
Fëmijë	36	23.1%
Zonat Rurale	93	59.6%
Zonat Urbane	63	40.4%

FSHDPAK lobon për ngritje fondesh nga burimet lokale, struktura shtetërore dhe private me qëllim plotësimin e kapacitetit të plote prodhues në fabrike duke mundësuar qëndrueshmërinë e këtij aktiviteti dhe plotësuar nevojat në rritje për mjete lëvizëse.

Karriget me rrota të prodhuara në punishten “Mirësia” janë të stilit aktiv, të dizenuara dhe testuara për qëndrueshmërinë në kushtet e terrenit të vendit të tyre. Karriget me rrota prodhohen bazuar në përmasat dhe nevojat individuale të personit me aftësi të kufizuara.

Bazuar në një studim të FSHDPAK rreth 7000 persona me aftësi të kufizuara kanë nevojë për mjete lëvizëse.

Përmes projektit “ Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara në nevojë për karrige me rrota”, mbështetur nga USAID deri tani kanë përfituar 468 persona me aftësi të kufizuara.

Karrigia me rrota ka plotësuar nevojat e individit në aspektin e lëvizshmërisë, përmasave, komfortit, sigurisë dhe aftësisë për të realizuar/kryer aktivitetet e jetës së përditshme duke garantuar të drejtat themelore të tij.

Pajisja me karrige me rrota e personave me aftësi të kufizuara në nevojë për të është një parakusht për integrimin e tyre në jetën social-ekonomike dhe kulturore të komunitetit. Projekti i mbështetur nga USAID ka kontribuar në rritjen e numrit të personave me aftësi të kufizuara, të cilët kanë me shumë shanse për të qenë të pavarur dhe marrë pjesë si të barabartë në jetën sociale.

- Projekti gjithashtu mbështet punësimin e 6 personave me aftësi të kufizuara, prej të cilëve 5 janë të përfshirë në prodhimin e karrigeve me rrota dhe një drejton avokatinë për përfshirjen e plote të PAK në shoqëri.

Në Shqipëri, mungesa e shanseve për punësim, të ardhurat e pamjaftueshme të familjes, janë faktorët kryesorë që ndikojnë në varfërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Duke konsideruar faktin që pothuajse 60% e PAK jetojnë nën nivelin e varfërisë dhe kanë të ardhura të kufizuara financiare, ky projekt po kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës por edhe të gjendjes së përgjithshme psikosociale të stafit me aftësi të kufizuara të punësuar në punishten “ Mirësia”.

Projekti është një model përmes të cilit personat me aftësi të kufizuara punojnë dhe prodhojnë për persona të tjerë me aftësi të kufizuara.

Jeta e tyre ka ndryshuar ekonomikisht, ata dhe familjet e tyre jetojnë më mirë, ata ndjehen të vlerësuar dhe të përfshirë në jetën e përditshme.



- Nga 18 deri me 23 shtator 2006, FSHDPAK organizoi në hotelin MAK Albania, ne bregdet, Kampin e 9-të Rehabilitimit Aktiv për personat me aftësi te kufizuar, përdorues e karrigeve me rrota, përfitues te karrigeve te stilit aktiv te prodhuara ne punishten “Mirësia” program i FSHDPAK. Ky është një aktivitet qe organizohet çdo vit nga FSHDPAK. Eshtë viti i tretë që ky aktivitet mbështetet nga USAID, nëpërmjet një granti qe ofron shërbime mbështetëse për njerëzit qe kane nevojë për karrige me rrota ne Shqipëri. 33 personave me aftësi të kufizuar (ne total ne tre vite 105) qe janë te pavarur ose qe mbështeten nga një i afërm, u është dhënë mundësia të bëhen bashkë dhe te organizohen ne një sërë aktivitete. Pesë dite aktivitete te organizuara çdo vit u ka dhënë mundësinë përdoruesve te karrigeve me rrota dhe kujdestareve te tyre, jo vetëm qe te trajnohen, por te kombinuara me aktivitete çlodhëse, sociale, sportive, ato krijojnë një rast për pushime te organizuara, qe ata rralle i gëzojnë ne gjithë jetën e tyre.

Kampi i Rehabilitimit Aktiv është i konceptuar ne organizim si një sesion i plote trajnimi, që përfshin aktivitete praktike me një game te tille, si: Teknika te Rehabilitimit Aktiv, Trajnim për Fizioterapi, Modeli Social, Çështjet Ligjore, Dita e Informacionit, Argëtim, Këshillim.

Qëllimi i Kampit te Rehabilitimit Aktiv është tu mësojë personave me aftësi te kufizuar aftësitë praktike qe kontribuojnë në pavarësinë e tyre.

Rehabilitimi Aktiv u është mësuar dhe do tu mësohet kryesisht përdoruesve te karrigeve ne rrota bazuar ne filozofinë: “Përdoruesit e karrigeve me rrota te mësojnë përdoruesit e tjerë te karrigeve me rrota për shprehitë e jetesës se përditshme”.

Dy përdorues të karrigeve me rrota janë trajnerë për përdoruesit e tjerë të karrigeve me rrota. Ky aktivitet u ndoq nga afër prej ekipit të medias duke përgatitur një dokumentar televiziv.

- Katër sesione trajnimi u organizuan me përdoruesit e karrigeve me rrota dhe pjesëtarët e familjeve të tyre, duke synuar rritjen e vetëvlerësimit, cilësisë së kujdesit dhe dhënies së shërbimeve, por edhe fuqizimin e vetë atyre në përpjekjet që bëjnë për avokatinë e të drejtave të tyre. 73 persona me aftësi të kufizuara, përdorues karrigje me rrota dhe pjesëtarë të familjeve të tyre përfituan nga këto sesione trajnimi.

Gjate shpërndarjes së karrigeve me rrota përfituesit dhe familjarët e tyre janë trajnuar për përdorimin e karrigjeve me rrota të stilit aktiv si dhe për të pasur aftësitë e nevojshme për jetesë të pavarur. Gjithashtu përfituesit e rinj të karrigeve me rrota dhe familjarët e tyre janë pajisur me informacione, botime të FSHDPAK, fletëpalosje, flete-info për aftësinë e kufizuar dhe legjislacionin në këtë fushë. Projekti ka mbështetur botimin e:

2 fletë - info: a. Çfarë është terapia, disa tipe të ushtrimeve të terapisë në paralizën cerebrale infantile. b. Dëmtimi në shtyllën kurrizore. Manual për përdorimin e karrigeve me rrota.

- Në kuadër të projektit janë zhvilluar ditë të informimit publik për çështje të aftësisë së kufizuar. Këto aktivitete janë organizuar në ditën e 3 Dhjetorit, Dita Ndërkombëtare e aftësisë së kufizuar në tre qytete kryesore të vendit; Shkodër, Elbasan dhe Vlorë. Për të informuar opinionin publik me qellim ndërgjegjësimin



dhe përmirësimin e qëndrimeve kundrejt çështjeve të aftësisë së kufizuar janë përgatitur dhe shpërndarë postera, fletëpalosje, flete-info. Mediat lokale kanë bere prezent për publikun me gjere këto aktivitete.

- Për te realizuar lobim efektiv me qellim përfshirjen e strukturave shtetërore, komunitetit te biznesit dhe atë me gjere ne ofrimin e subvencioneve për te plotësuar nevojat për karrige me rrota te personave me aftësi te kufizuar ne Shqipëri si dhe avokati për shmangien e barrierave drejt shanseve me te mëdha per arsimim, punësim, etj për PAK janë zhvilluar takime, seminare, konferenca duke mundësuar:
 - Ndërgjegjësim dhe përgjegjësi ne rritje te nderrmara nga qeveria shqiptare, qe nevojitet te formalizohet gjate vitit 2007, për të subvencionuar prodhimin e karrigeve me rrota ne punishten “ Miresia”.
 - Ndergjegjesim te komunitetit te biznesit. Fondacioni VODAFONE është sensibilizuar për mbështetje te vazhdueshme dhe subvencion te prodhimit te karrigeve me rrota ne punishten “ Miresia” në 2007. Gjate vitit 2006 VODAFONE – Albania ka subvencionuar prodhimin e 30 karrigeve me rrota për PAK te varfër ne nevoje per to. Deri tani nga mbështetja qe VODAFONE FOUNDATION ka ofruar për prodhimin e mjeteve lëvizëse ne punishten “Mirësia” kane përfituar 130 persona me aftësi te kufizuar ne nevojë për karrige me rrota ne Shqiperi.
 - Angazhimin e qeverise shqiptare për një mjedis te lire nga barrierat arkitektonike si dhe shanse te barabarta per personat me aftesi te kufizuar. Këtij qëllimi i kane shërbyer përmirësimi i kuadrit ligjor (miratimi i VKM per amendamente ne Statusin e Paraplegjikeve ne shtator 2006) .

Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të PAK në Shqipëri

Objektivat

- Rritja e ndërgjegjësimit përmes seminareve dhe fushatave ndërgjegjëse për të informuar kryesisht personat me aftësi të kufizuar dhe të gjithë aktorët përkatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, siç shprehet qartë në të pesë fushat e ndërhyrjes së Strategjisë Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar (SKPAK).
- Sigurimi i asistencës për të siguruar implementimin e SKPAK, duke rritur kapacitetet e organizatave për aftësinë e kufizuar dhe të gjithë aktorëve përkatës, përmes trajnimit dhe ekspertizës e konsulencës teknike nga profesionistë të aftësisë së kufizuar, vendas, rajonal apo ndërkombëtar.
- Krijimi i një metodologjie monitoruese dhe përgatitja e një raporti monitorimi vjetor, si një instrument për të stimuluar zbatimin e strategjisë kombëtare mbi aftësinë e kufizuar, përmirësimin dhe zbatimin e saj të vazhdueshëm.
- Zhvillimi i një rrjeti eficient me një gamë të gjerë aktorësh të shoqërisë civile, qeverisë dhe sektorit privat për të siguruar një bashkëpunim potencial dhe për të çuar më tej axhendën e advokatisë për aftësinë e kufizuar. Përcaktimin e një strategjie për angazhim të vazhdueshëm me politikë-bërësit dhe zbatuesit, përfshirë agjencitë shtetërore, partitë politike, organizatat zhvilluese dhe organizatat ndërkombëtare duke patur si qëllim angazhimin e tyre adekuat.

Projekti synon të përmirësojë të kuptuarit dhe qëndrimet e të gjithë agjencive përkatëse, qeveritare dhe joqeveritare, politikëbërësit dhe të gjithë shoqërisë duke promovuar SKPAK në nivel kombëtar dhe lokal, rritjen e kapaciteteve të Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe të gjithë aktorëve përkatës, përmes trajnimit përkatës dhe ekspertizës teknike dhe konsulencës nga profesioniste të aftësisë së kufizuar kombëtarë, rajonale dhe ndërkombëtarë, rritjen e përgjegjshmërisë duke zhvilluar raporte vjetore monitoruese pasqyruese si një instrument, për monitorimin konsistent të implementimit të SKPAK, zhvillimit të rrjeteve të zgjeruara për ta avancuar dhe për ta sjellë aftësinë e kufizuar në axhendat e avokatisë dhe reformave të tjera duke sfiduar përjashtimin dhe ndërhyrjen fragmentare dhe duke promovuar një shoqëri gjithëpërfshirëse.

Aktiviteti i zhvilluar ne periudhen shtator – dhjetor 2006 mund te konsiderohet si faze përgatitore, qe përgatiti infrastrukturën e domosdoshme ne lidhje me burimet materiale dhe njerëzore që do të përfshihen në zhvillimin e projektit.

- Hartimi i planit operacional te aktiviteteve për vitin kalendarik tetor 2006 - tetor 2007;
- Përcaktimi i termave te referencës për grupin e eksperteve qe do te zhvilloje strategjinë e monitorimit;
- Përcaktimi i termave te referencës për koordinatorët që do të përfshihen në nivel vendor;

Pasi u përgatitën dokumentet, u krye procedura e përzgjedhjes dhe u kontraktuan 5 ekspertë për çdo fushë te SKPAK. Ekspertet u përzgjedhën për te punuar ne fushat e mëposhtme:

Përshtatshmëri/ Shërbime Shëndetësore/ Shërbime Sociale/ Arsimim/ Punësim
Janë organizuar takime te ndryshme te grupit te eksperteve në mënyrë qe te përcaktohej qartë metodologjia qe do te përdorej për planin e veprimit për te realizuar procesin e monitorimit, duke përfshirë dhe aktivitete te tilla; përcaktimi i treguesve, krijimi i instrumenteve monitorues si, pyetësorët, vëzhgimet, diskutimet e grupeve te fokusit me aktoret përkatës në secilën prej fushave, planifikimi dhe organizimi i trajnimeve nga secili ekspert me një grup te identifikuar që do të mbledh informacionin në nivel vendor, etj.

Gjate kesaj periudhe jane perzgjedhur edhe koordinatorët lokale te cilet do te koordinojne dhe zbatojne ne nivel lokal planin e veprimit te percaktuar.



ASISTENCË LIGJORE DHE AVOKATI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

DONATOR: KOMITETI SUEDEZ I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT
BUXHETI: 63, 071.86 EURO
PERIUDHA: 1 JANAR 2006 – 31 DHJETOR 2006

FSHDDPAK ka iniciuar prej muajit Shtator 2004 Programin “Avokati dhe Asistencë Ligjore për Personat me Aftësi të Kufizuar”, me veprimtari në qytetet Tiranë, Shkodër, Korçë, Elbasan, Durrës, Vlorë, projekt i financuar nga Komiteti Suedez i Helsinkit për te Drejtat e Njeriut.

Ky program ka si mision mbrojtjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK), përmirësimin e kuadrit ligjor, dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Objektivat

- Ofrimin dhe përmirësimin e shërbimit ligjor falas për personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre.
- Rritjen e ndërgjegjësimit mbi njohjen me të drejtat e njeriut, dhe në veçanti të drejtat e PAK, si edhe me parimet e shtetit ligjor nga të gjithë aktorët përgjegjës.
- Lobim dhe Advocaci për përmirësim dhe zbatimin të legjislacionit shqiptar mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Si veprojnë zyrat ligjore



Programi Ligjor nëpërmjet 7 Avokatëve dhe Juristëve asiston dhe ofron çdo ditë këshillim dhe asistencë ligjore për të gjithë PAK dhe familjarët tyre. Përfaqëson ligjërisht PAK në mbrojtje të të drejtave të tyre përpara institucioneve të Administratës Publike dhe në ato raste kur konstatohet shkelje, abuzim apo moszbatim i ligjit, PAK apo familjarët e tyre përfaqësohen ligjërisht nga Avokatët e këtij programi në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor.

Gjatë vitit 2006 Zyra ligjore ka trajtuar një numër total prej 989 raste, nga këto Tirana 209 raste, Durrësi 174 raste, Shkodra 187 raste, Elbasani 121 raste, Vlora 173 raste dhe Korça 98 raste.

448 raste administrative janë ndjekur në Tiranë dhe në 5 qytete e tjera ku vepron Programi Ligjor (Vlore, Durrës, Shkodër, Elbasan dhe Korçë).

Në sistemin gjyqësor është ofruar përfaqësim ligjor falas për 16 raste, në Tiranë 3 raste, Korça 4 raste, Durrës 3 raste, Elbasan 2 raste, Vlora 2 raste dhe Shkodra 2 raste.

Rastet gjithsej për vitin 2006, në qytetet ku vepron programi ligjor, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:



Përfshirje në ndryshime ligjore

Zyra Ligjore ofron dhe asiston me ekspertizë ligjore, në bashkëpunim me Programin e Avokatisë, Qeverinë Shqiptare në të gjitha ndryshimet dhe përmirësimet ligjore në fushën e aftësisë të kufizuar, si dhe asiston me ekspertizë ligjore Shoqata që ndërmarrin iniciativa ligjore në këtë fushë.

Programi ligjor bazuar në objektivat e vitit 2006, me ekspertizën e një grupi prej 4 Avokatësh (ekspertë në legjislacionin e aftësisë së kufizuar) realizuan një raport studimor “Studim dhe vlerësim i legjislacionit të aftësisë të kufizuar”. Raporti studimor kishte për qëllim vlerësimin e legjislacionit shqiptar në përputhje me dokumentat ndërkombëtar të ratifikuar nga shteti shqiptar si dhe nxjerrjen në pah të mangësive ligjore të legjislacionit që vepron në fushën e aftësisë të kufizuar. Ky studim u shoqërua me një sërë rekomandimesh drejtuar qeverisë shqiptare, rekomandime të bëra prezent gjatë konferencës për shtyp datë 2.09.2006, në të cilën mori pjesë edhe Ministri i Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, z. Koço Barka.

FSHDPAK gjatë vitit 2006 është përfshirë edhe në aktivitetet e mëposhtme ligjore;

- FSHDPAK ka qenë pjesë e grupit të punës në hartimin e dokumentit të “Standardeve të PAK në qendrat ditore dhe rezidenciale”.
- Programi ligjor ka qenë pjesë e grupit të punës dhe ka dhënë rekomandimet për hartimin e projekt-ligjit “Anti-diskriminues” lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar (iniciuar nga “Grupi Shqiptar për të drejtat e Njeriut”).
- Programi ligjor ka qenë pjesë e grupit të punës dhe ka dhënë rekomandimet për hartimin e projekt-ligjit “Për fuqizimin e programit të veprimit ndaj minave në RSH” (iniciuar nga AMAE dhe Ministria e Mbrojtjes).
- MPÇSSHB ka ngritur grupin e punës për mbledhjen dhe mbajtjen e të dhënave statistikore të PAK, pjesë e të cilit është edhe FSHDPAK (grup i cili është ngritur në saj të rekomandimeve të “Studimit dhe vlerësimit të legjislacionit në fushën e AK”).



Publikime

Gjatë vitit 2006, Zyra Ligjore ka publikuar;

- 2 guida udhëzuese “Mbi ligjin për Statusin e Invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” dhe guidën udhëzuese “Mbi Ligjin për ndihmë dhe shërbime shoqërore”.
- Paketën Ligjore në fushën e aftësisë së kufizuar (publikim i cili përmbledh gjithë legjislacionin shqiptar që vepron në RSH) .
- “Studim dhe vlerësim i legjislacionit të aftësisë të kufizuar” (botim i realizuar nga një grup prej 4 Avokatësh, me eksperiencë në fushën e legjislacionit të aftësisë së kufizuar).
- Revista “Sfida”, përgjatë vitit 2006 janë realizuar numrat 21, 22, 23.

Realizimi i botimeve të përmendura, ka sjell jo vetëm pasurimin e Qendrës Burimore të informacionit pranë FSHDPAK por ka rritur ndër të tjera edhe numrin e përfituesve PAK. Përreth 420 fletëpalosje, 350 paketa ligjore, 611 guida udhëzuese janë shpërndarë në të gjithë rrejetin bashkëpunues të FSHDPAK në të gjithë Shqipërinë.

Bashkëpunimi me median

Zyra ligjore ka bashkëpunuar ngushtësisht me median si të shkruar dhe elektronike për bërjen publike të të gjitha rasteve në të cilat janë konstatuar shkelje e të drejtave dhe diskriminim i PAK. Në një numër të konsiderueshëm artikujsh vend të rëndësishëm kanë zënë nxjerrja në pah e problematikave që hasin PAK në çdo aspekt të jetës së tyre, mos garantimi i të drejtës për arsimimin gjithëpërfshirës, të drejtës për strehim, të drejtës për punësim dhe të sigurimit të një standardi minimal jetese, të drejtës për shërbime shoqërore apo mangësive ligjore.

Gjatë viti 2006 në bashkëpunim me median lokale, me mbështetjen financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit për të drejtat e Njeriut, janë realizuar 3 debate të hapura publike në qytetet Elbasan, Shkodër dhe Durrës. Debatet u realizuan në televizionet më të njohura



në këto qytete, respektivisht në Elbasan “TV Egnatia”, Durrës “TV Teuta” dhe Shkodër “TV Rozafa”. Në debate ishin pjesëmarrës jo vetëm persona me aftësi të kufizuar dhe shoqata që veprojnë në fushën e aftësisë të kufizuar, por në funksion të qëllimit të debatit, përfaqësues të institucioneve administrative vendore zinin pjesën më të gjerë të panelit. Debatet kishin për qëllim bërjen prezent të shqetësimit dhe problematikave që komuniteti i personave me aftësi të kufizuar ndesh çdo ditë, si edhe të sillte në vëmendje të pushtetit vendor detyrimet dhe përgjegjësitë ligjore që ata kanë në funksion të zbatimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit



Institucioni i Avokati i Populli në bashkëpunim me “Save the children, Albania” “Unicef”, “Këshillin Kombëtar të Aftësisë të Kufizuar” dhe “Fondacionin Shqipëtar për të Drejtat e PAK” organizoi në datë 11.12.2006 konferencën kombëtare me temë “Të drejta dhe dinjitet të barabartë për personat me aftësi të kufizuar”. Pjesë e konferencës ishin jo vetëm shoqatat dhe qendrat, që veprojnë në mbrojtje dhe promovim të të drejtave të PAK, si në nivel kombëtar dhe lokal, por edhe përfaqësues të lartë të institucioneve qendrore përgjegjës për hartim dhe zbatim të politikave dhe legjislacionit në fushën e aftësisë së kufizuar.

Fondacioni Shqiptar për të drejtat e PAK luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e kësaj konferencë në bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit. Ofrimi i materialeve burimore lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të PAK si dhe prezantimet në këto konference nga Drejtori Ekzekutiv i FSHDPAK Zj. Blerta Çani dhe Koordinatorës të programit të Avokatisë pranë FSHDPAK zj. Bardhylka Kopsiri me temë “Legjislacioni, si zbatohet, mangesitë dhe problematikat e aftësisë të kufizuar në Shqipëri”. Konferenca ndikoi pozitivisht, duke i sjellë edhe njëherë në vëmendje Qeverisë Shqiptare detyrimet ligjore që janë sanksionuar nga legjislacioni shqiptar dhe nga konventat e ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë në fushën e aftësisë të kufizuar, me qëllim garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.



PËRFSHIRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË PROCESET ELEKTORALE DHE POLITIKE

DONATOR: IRI/USAID
BUXHETI: 18,000 \$
PERIUDHA: DHJETOR 2006 – QERSHOR 2007

FSHDDPAK realizoi projektin “Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuar në Proceset Elektorale dhe Politike” në bashkëpunim dhe me mbështetjen e IRI / USAID në zgjedhjet vendore të 18 Shkurtit 2007, pjesa përgatitore parazgjedhore e të cilit u zhvillua gjatë vitit 2006.

Projekti u shtri në tre rajone të Shqipërisë

- Shkodër, nëpërmjet degës lokale të FSHDDPAK – “Qendra për Shanse të Barabarta”
- Tiranë, në bashkëpunim me shoqatën “Ndihmoni Jetën”
- Librazhd, në bashkëpunim me shoqatën MEDPAK .

duke përfshirë edhe shoqatat e të gjithë spektrit të aftësisë së kufizuar.

Projekti fokusohet në dy drejtime kryesore:

- 1) Përfshirja e PAK në proceset politike
- 2) Përfshirja e PAK në proceset elektorale

Aktivitete

U synua në ndërgjegjësimin dhe influencimin e subjekteve politike (në nivel qendror dhe vendor) për ta përfshirë problematikën e AK në programet elektorale. Për këtë u përgatit një Manifest Zgjedhor, drejtuar të gjitha subjekteve, kandidatët e të cilave ishin pjesë e garës elektorale, si edhe administratës zgjedhore, me problematikën e AK për t'i përfshirë në Programet Elektorale. Për hartimin e Manifestit ekspertët e 10 shoqatave të PAK zhvilluan 8 takime deri në variantin final.

Manifesti u prezantua në një konferencë për shtyp, me pjesëmarrjen e të gjitha organizatave të Aftësisë së Kufizuar dhe disa përfaqësuesve të subjekteve politike, në praninë e Mediave elektronike dhe të shkruar. Manifesti iu shpërnda elektronikisht dhe zyrtarisht të gjitha subjekteve politike dhe administratës zgjedhore.

Manifesti u përshtat dhe u shpërnda në nivel vendor në: Tiranë, Shkodër dhe Librazhd, nga rrjetet lokale të AK që u trajnuan për këtë qëllim.

U përgatit një spot televiziv (30 s), me thirrjen ndaj kandidatëve për drejtues të njësive vendore për përfshirjen e problematikës AK në programet e tyre. Ky spot u shfaq për një periudhë 10 ditore në tre kanale televizive të rëndësishme në orët dhe programet më të ndjekura nga shikuesit. U zhvilluan katër takime me drejtues të subjekteve kryesore politike të pozitës dhe opozitës.

U realizua pjesëmarrja në forume dhe në takime elektorale, si në mini-bashkinë 2 në Tiranë; në Librazhd ku u organizua forum i posaçëm, etj. Për zhvillimin e këtyre fushatave ndërgjegjësuere u përzgjedhën grupe lobuesish (persona AK dhe prindër) të cilët u trajnuan (tre trajnime) për të njohur të drejtat e AK si dhe për të zhvilluar një proces avokatie e lobimi.

U përgatit zhvillimi i një trajnimi avokatie më i gjerë me përfaqësues të IRI-it dhe ekspert shqiptar në proceset elektorale dhe të shoqërisë civile, me përfaqësuesit e të gjitha shoqatave të AK.

Problematika e aftësisë së kufizuar, me kërkesa konkrete të paraqitura në Manifestin Zgjedhor të Personave me Aftësi të Kufizuar, u bë pjesë e programe elektorale të disa partive parlamentare.



KONVENTA PER TE DREJTAT E PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUAR

DONATOR: UN VOLUNTARY FUND ON DISABILITY
BUXHETI: 9,174\$
PERIUDHA JANAR 2006 – MAJ 2006

Me synim ndergjegjesim dhe perfshirjen e gjithe aktoreve pergjegjes dhe grupeve te interesit ne nje moment shume te rendesishem per jeten dhe te drejtat e njerzve me aftesi te kufizuara edhe ne Shqiperi, Fondacioni Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuara, hartoi nje program te detajuar mbi “Konventen per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuara” realizimi i te cilit u be i mundur permes mbeshitetjes se Fondit Vullnetar te OKB per aftesine e Kufizuar (UN Volunatry Fund on Disability)

Zbatimi me sukses i projektit, pjesemarrja aktive ne seminare, trajnime ndikoi ne zgjerimin e njohurive dhe kapaciteteve te perfaqesuesve te organizatave kombetare dhe lokale te aftesise se kufizuar ne Tirane dhe 8 rajone te Shqiperise, te perfaqesuesve te administrates shtetore ne nivel qendror dhe lokal te fushave te kujdesit shoqeror dhe shendetesor, arsimim, punesim, pershtatshmeri etj, ne lidhje me te drejtat e njerzve me aftesi te kufizuara, sikurse te shprehura ne konvente.

Perfaqesues te Qeverise Shqiptare, ne Ministrine e Punëve te Jashtme, Ministrine e Punës Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, si dhe anetare te parlamentit shqiptar jane perfshire permes kontakteve te vazhdueshme, shkembimit te informacionit duke bere te mundur një qëndrim pozitiv dhe angazhimin e tyre ne procesin e hartimit te Konventës dhe shprehjen e gadishmerise per ratifikimin e saj.

Krijimi i kapaciteteve te perfaqesuesve te medias ne Tirane dhe ne 8 rajone te targetuara nga ky projekt, mbi ceshtje qe lidhen me kete moment dhe dokument historik per jeten njerzve me aftesi te kufizuara, ndikoi ne realizimin e nje fushate intensive, shume te domosdoshme per te nxitur ndergjegjesim dhe pjesemarrje te te gjithë aktoreve te rendesishem ne kete proces, njekohesisht per te nxitur nje qëndrim pozitiv te gjithë shoqerise ndaj te drejtave dhe lirive themelore te personave me aftesi te kufizuar.



NDËRTIMI I NJË PROGRAMI ZHVILLIMI PËR NJË KOMUNITET GJITHËPËRFSHIRËS (BIDC)

DONATOR: MIUSA/ USAID
BUXHETI: 4,890 \$
PERIUDHA: MAJ 2006 – SHTATOR 2006

Ndërtimi i një programi zhvillimi për një komunitet gjithëpërfshirës, financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) është projektuar për të zbatuar në fusha specifike të vendit, bazuar në asistencën teknike për të rritur pjesëmarrjen e njerëzve me aftësi të kufizuar, duke përfshirë gratë dhe burrat, në programet ndërkombëtare të zhvillimit të SHBA si pjesëmarrës, aktorë, administratorë dhe konsulentë.

Projekti ishte shumëplanësh, bazuar në asistencën teknike në vend dhe trajnimin nga MIUSA të përfituesve dhe kontraktuesve të granteve të USAID, organizatave vendore të personave me aftësi të kufizuar, stafin e Misionit dhe programe të sponsorizuara të misionit në Shqipëri, Ekuador dhe Guatemalë.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Njerëzve me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK) ishte partneri shqiptar për MIUSA në Shqipëri.

FSHDPAK koordinoi dhe mori pjesë në të gjithë aktivitetet e projektit BIDC në Shqipëri. Përfaqësues të shumtë të FSHDPAK morën pjesë dhe moderuan aktivitetet trajnuese që u zhvilluan.

Projekti BIDC përfshin veprime që do të angazhojnë stafin e FSHDPAK në veprime zhvillimi gjithëpërfshirëse me partneret implementues të USAID si dhe rritjen e kapacitetit të organizatave të personave me aftësi të kufizuar (OPAK) dhe personave me aftësi të kufizuar për të mbrojtur dhe promovuar praktikën gjithëpërfshirëse të zhvillimit. Çdo ndërhyrje e projektit u ndërtua për të forcuar marrëdhëniet dhe për të promovuar pjesëmarrjen e qëndrueshme afatgjate të njerëzve me aftësi të kufizuar si pjesëmarrës të zhvillimit, si staf, partnerë dhe vendimmarrës.

Kjo ndërhyrje përfshin:

Asistencë Teknike në Terren

Asistencë teknike specifike për vendin e bazuar në trajnim dhe mbështetje në vazhdim, dhënë kontraktuesve dhe përfituesve të granteve të USAID; partnerëve zbatues vendorë, duke përfshirë organizatat e njerëzve me aftësi të kufizuar; stafin e Misionit dhe programet e aktivitetet e sponsorizuar nga Misioni.

Ndërtimi i Kapaciteteve

Organizatave të personave me aftësi të kufizuar (OPAK) do të merrnin pjesë në programet e trajnimit të projektuara për të forcuar kapacitetin e tyre organizativ dhe aftësitë e avokatisë, për të promovuar dhe moderuar përfshirjen e njerëzve me aftësi të kufizuar në organizata dhe programe zhvillimi.

Ndërtimi i Marrëdhënieve

Krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve midis organizatave të zhvillimit, kontraktuesve dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuar është çelësi për një gjithëpërfshirje të qëndrueshme dhe afatgjatë. MIUSA dhe FSHDPAK kanë lehtësuar ndërtimin e marrëdhënieve mes aktoreve të programit.

Shpërndarja e Informacionit

Programet e suksesshme dhe informacionet e përfituesve, sfidat dhe mësimet e nxjerra, do të vihen në dispozicion të partnereve dhe pjesëmarrësve vendorë, organizatave ndërkombëtare të zhvillimit dhe asistencës humanitare, organizatave të aftësisë së kufizuar dhe zhvillimit dhe Misioneve të USAID.

Veprimtaritë dhe rezultatet kryesore të projektit gjatë vitit 2006 përfshijnë:

- Veprimtari me Misionin USAID në Shqipëri/Kontraktuesit dhe Partnerët Zbatues të USAID

Përfaqësuesit e USAID/ Partnerët zbatues Shqipëri, morën pjesë në një program trajnimi të projektuar dhe zbatuar së bashku nga FSHDPAK dhe MIUSA për zhvillimin gjithëpërfshirës të aftësisë së kufizuar. Në trajnim, MIUSA dhe FSHDPAK i dhanë çdo pjesëmarrësi një kompakt disk me artikuj, burime dhe komplete me mjete që ndihmojnë çdo organizatë që të marrë njohuri shtese dhe këshilla praktike në fushën specifike të veprimtarisë së saj.

• Veprimtari me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Advokuesit

Mbledhjet me 22 OPAK dhe 9 persona me aftësi të kufizuar aktivë krijoi mundësi për të shkëmbyer informacion dhe për të marre njohuri dhe koncepte për zhvillimin gjithëpërfshirës. Gjatë sesioneve të trajnimit, trajnuesit e MIUSA-s dhe FSHDPAK mblodhën, gjithashtu informacion për të asistuar në planifikimin dhe lehtësimin e aktiviteteve trajnuese dhe punëve në grup për të rritur kapacitetin e OPAK shqiptare. Udhëheqës dhe përfaqësues nga shumë OPAK punuan në ekipe, duke komunikuar në tri gjuhë (shqip, anglisht dhe gjuhen e shenjave) për të identifikuar strategjitë e aftësisë së kufizuar në fushat e Shëndetit, Rritjes Ekonomike, Arsimit dhe Pjesëmarrjes Qytetare.

Veprimtari të veçanta trajnuese u organizuan me një grup prej 23 grash me aftësi të kufizuar për të përmirësuar aftësitë e tyre drejtuese dhe për t'i mobilizuar si promovuese proaktive të ndryshimit në organizatat dhe komunitetin e tyre.

• MIUSA/ FSHDPAK realizoi gjithashtu vizita tek Kontraktuesit e USAID-it dhe OPAK dhe ofroi konsulencë stafit të USAID-it, me qëllim vënie në veprim të planeve të zhvillimit gjithëpërfshirës.

Në disa aktivitete të përbashkëta me Misionin e USAID, kontraktuesit e USAID-it dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuar (OPAK) u identifikuan detyra të arritshme lehtë që do të çojnë në rezultate gjithëpërfshirëse praktike dhe ushqejnë marrëdhënie të qëndrueshme me Organizata të PAK Shqiptare.

III.

Informacion Financiar

Lista e projekteve dhe donatoreve te FSHDPAK gjatë vitit 2006

TITULLI I PROJEKTIT	DONATORET	TË ARDHURA	SHPENZIME
Qender Burimore per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar	CORDAID/Hollande	176,436.39	132,254.18
Asisistence Ligjore dhe Avokati per Personat me Aftesi te Kufizuar ne 6 Rajone te vendit.	Komiteti Suedez I Helsinkit per te Drejtat e Njeriut	63,071.86	63,106
Sherbime Mbeshtetese per Njerezit ne Nevoje per Karrige me Rrota ne Shqiperi	USAID	118,828	110,618
Mbeshtetje per Njerez ne Nevoje per Karrige me Rrota	Fondacioni VODAFONE	6,985	6,985
Nxitja e Krijimit te nje Komuniteti Gjithepershires	MIUSA/USAID	4,890.15	4,890.15
E Drejta e Votes per Personat me Aftesi te Kufizuar ne Shqiperi	IRI/USAID	18,000	0
Promovimi I Konventes se Kombeve te Bashkuara per Mbrojtjen e te Drejtave te Personave me Aftesi te Kufizuar	UN Voluntary Fund on Disability	9,174	9,174
TOTAL		397,385	327,027

ALBANIAN DISABILITY RIGHTS FOUNDATION Tirana - Albania

Balance Sheet as of 31st December 2006

for the period from 1-st Jan 2006 to 31st Dec 2006

(amounts in Euro)

(1 Euro = 122.72 ALL)

	2006	2005	2006	2005
Fixed Assets				
Tangible fixed assets				
Land, Buildings	307,841.57	280,703.98		
Furniture, Equipment	41,500.85	92,691.16		
Total fixed assets	<u>349,342.42</u>	<u>373,395.14</u>		
Current assets				
Stock	43,714.66	23,708.29		
Diff from the conversion	249.87			
Receivables				
Cash and bank	<u>105,022.63</u>	<u>80,096.05</u>		
Total Current assets	<u>148,987.16</u>	<u>103,804.34</u>		
Total Assets	<u>498,329.58</u>	<u>477,199.48</u>		
			Current liabilities	
			Creditors /payables	
			Social Sec to be paid	2,619.41
			Taxes to be paid	1,083.06
			Bal of project funds	28,441.29
			Diff from the conversion	563.19
			Total Current liabilities	<u>4,265.66</u>
				<u>29,639.53</u>
			Equity	
			General reserve	
			Continuation reserve	494,063.92
			Total liabilities and equity	<u>498,329.58</u>
				<u>477,199.48</u>

IV. Raporti i Auditimit



To the Board of Directors of the Albanian Disability Rights Foundation

Independent Auditor's Report

Fabel, Werner & Schnittke GmbH has carried out an audit of the financial report on the project "Disability Resource Center" of the Albanian Disability Rights Foundation (ADRF) as of 31 December 2006. The financial report is the responsibility of the management of the organisation. Our responsibility is to express an opinion on the financial report based on our audit.

We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. The International Standards on Auditing require that we plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the financial statements are free of material misstatement. An audit includes examining, on a test basis, evidence supporting the amounts and disclosures in the statement. An audit also includes assessing the accounting principles used and significant estimates made by management, as well as evaluating the overall financial statements' presentation. We believe that our audit provides a reasonable basis for our opinion.

The financial project report was prepared on the cash basis of accounting. On this basis, income is recognized when received rather than when earned, and expenses are recognized when paid rather than when incurred. The accompanying financial report was prepared to present the funds received and the expenditures incurred by the project and is not intended to be a complete presentation of the organisation's operations.

In our opinion, the accompanying financial report gives a true and fair view of funds received and disbursements made as of 31 December 2006 in accordance with the cash basis of accounting as described above.

Tirana, 23 May 2007



Fabel, Werner & Schnittke GmbH

Thomas Werner
Certified Public Accountant

Etleva Dhamo
Certified Accountant

V.

PLANIFIKIMI STRATEGJIK I FSHDPAK

2006-2009

NGA MISIONI TEK DREJTIMET STRATEGJIKE

Shqetësimet kryesore qe lidhen me fushat e ndërhyrjes se FSHDPAK	Drejtimet strategjike te FSHDPAK	Qëllimet strategjike organizative
<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e aksesit ne sistemin e drejtesise/ne informacion dhe ndihme ligjore për PAK dhe pjesëtarët e familjes së tyre. 	<p>Promovimi i shtetit ligjor dhe mbrojtja e te drejtave njerëzore te PAK</p>	<p>1.1 – Ofrimi i këshillimit/orientimit ligjor dhe avokati te çështjeve ne gjyq duke ndihmuar rreth 1200 PAK dhe familjet e tyre me te gjitha çështjet ligjore qe lidhen me aftësinë e kufizuar (400/ne vit/përparësi PAK intelektuale).</p>
<ul style="list-style-type: none"> - Mangësi/moszbatimi i kuadrit ligjor shqiptar qe garanton te drejtat e PAK. 		<p>1.2 – Ndërmarrja e lobingut dhe iniciativës se avokatisë për përmirësimin dhe zbatimin e legjislacionin qe lidhet me te drejtat qytetare, ekonomike dhe kulturore te PAK/fokusimi tek ligji për shanset e barabarta (mosdiskriminimi dhe ndjeshmëria gjinore midis grupeve te ndryshme te PAK per te zhdukur diskriminimin ne menyre te veçante te PAK intelektuale për te cilët kujdesi është me i pakti, zhdukja e diskriminimit qe ekziston mes njerëzve me AK dhe atyre pa AK)</p> <p>* përpjekje te vazhdueshme avokatie te fushave te targetuara te FSHDPAK (pershtatshmeria/ arsimimi/ punësimi/ aksesit zgjedhor/</p>

		* përpjekje te vazhdueshme avokatie per te siguruar pjesëmarrjen e PAK ne diskutimet për Konventën e OKB për mbrojtjen e te drejtave te PAK dhe garantimin nga Qeveria shqiptare qe jo vetëm te përfshihet ne hartimin e saj por edhe ta ratifikoje atë.
- Mungesa e strukturave dhe sistemeve monitoruese për ta bere Qeverinë shqiptare përgjegjëse për zbatimin e politikave kombëtare për aftësinë e kufizuar.	Promovimi qeverisjes se mire qe trajton çështjet e PAK	1.3 – Krijimi i një sistemi monitorues dhe garantimi i raporteve vjetore hije/ alternative për Barazimin e shanseve për PAK siç deklarohet ne Strategjinë Kombëtare për Aftësinë e Kufizuar miratuar nga Qeveria shqiptare ne Janar 2005. Monitorimi i veçante dhe raportet do te shkruhen gjithashtu për PAK intelektuale duke qene me te diskriminuarit dhe ato do te inkorporohen ne raportet e përgjithshme për shanset e barabarta PAK)
- Mungesa e shanseve te punësimit për PAK - 60% e PAK mbështeten ne te ardhura shume te pakta. - 9000 njerëz kane nevojë për mjete lëvizëse/ - politika te pamjaftueshme subvencionimi nga ana e Qeverise shqiptare dhe komuniteteve te tjerë	Mbështetje dhe shërbime sociale për PAK	2.1 Përmirësimi i integritit social dhe nivelit ekonomik te PAK nëpërmjet shanseve te punësimit te ofruara nga punishtja 'Mirësia' e FSHDPAK .2.2 Sigurimi qe PAK te furnizohen me mjete lëvizëse, prodhime te punishtes 'Mirësia' 2.3 Sigurimi i vazhdimësisë se aktivitetit prodhues se punishtes nëpërmjet subvencionimit te siguruar nga burime te ndryshme, kryesisht nga Qeveria shqiptare si pjese e politikave te saj sociale.
- Diskriminimi dhe izolimi/ institucionalizimi i PAK, kryesisht i atyre me aftësi te kufizuar mendore ose te shumëfishte	Kujdesi komunitar, fuqizimi dhe pjesëmarrja e komunitetit te PAK (përparësi u jepet njerëzve me aftësi te kufizuara intelektuale)	3.1 – Zgjerimi i rolit te Qendrës për Burimet për Aftësinë e Kufizuar ne Qendrën për Zgjerimin e Shanseve te Përfshirjes (CDIO), dhe përsëritja e saj ne te paktën tre zona te tjera te vendit.

<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e kapaciteteve midis vete njerëzve me aftësi te kufizuara/ anëtarëve te familjes/zyrtareve përgjegjës qeveritare - Mungesa e mbështetjes se familjes dhe shërbimeve te tjera mbështetëse te domosdoshme për sigurimin e pjesëmarrjes se PAK - Familje te mbingarkuara dhe te dërmuara nga puna dhe avokati e pamjaftueshme për te drejtat e njerëzve me aftësi te kufizuara intelektuale. - Politika shtetërore te pamjaftueshme dhe praktika pozitive për njerëzit me aftësi te kufizuar intelektuale gjithashtu te pamjaftueshme 		<p>3.2 – Përmirësimi i aftësive te PAK/ anëtarëve te familjes dhe te gjithë aktoreve kryesore përmes trajnimit / këshillimit / ekspertizës.</p> <p>3.3 – Sigurimi i avokatisë / mbështetjes për familjen/mbështetje për shkollën/ mbështetje për punësim dhe mbështetje e pjesëmarrjes se komunitetit me një qasje te menaxhimit te çështjes për një total prej 360 njerëzish me aftësi te kufizuar (40 çështje për rreth x 3 rrethe x 3 vite). Përdoret një qasje rast pas rasti.</p> <p>3.4 – Krijimi i rrjetit te avokatisë se prindërve ne nivel vendor dhe përfshirja e tyre ne proceset e vendimmarrjes për njerëzit me aftësi te kufizuara intelektuale.</p> <p>3.5- Zhvillimi i avokatisë efçente ne mënyrë qe te ndikohet ne politikat dhe praktikat qeveritare për te përfituar njerëzit me aftësi te kufizuara mendore dhe intelektuale. Përdorimi i përpjekjeve monitoruese te FSHDPAK (1.3) për te vene ne pah dhe për te pasur si përparësi në programet qeveritare njerëzit me aftësi te kufizuara mendore dhe intelektuale.</p>
<p>PAK janë akoma te padukshëm për shkak te një sere barrierash fizike dhe psikologjike qe kulmojnë ne perceptimet kulturore dhe qëndrimore qe kufizojnë rreptësisht aksesin e tyre ne jetën e pergjithshme. Kjo inkurajon mungesën e imazheve pozitive te njerëzve me aftësi te kufizuar gjë qe çon ne një margjinalizim dhe diskriminim te mëtejshëm.</p>	<p>Edukimi Qytetar/ Ndërgjegjësimi Publik</p>	<p>4- Përdorimi i çdo shansi për te kërkuar publicitet dhe ndërgjegjësim për te ndryshuar imazhet negative për njerëzit me aftësi te kufizuara duke i kushtuar vëmendje te veçante evidentimit te pozicionit te njerëzve me aftësi te kufizuara mendore dhe intelektuale dhe grave me aftësi te kufizuara, ne mënyrë qe brezat e ardhshëm t'i pranojnë njerëzit me aftësi te kufizuara si pjesëtarë te barabarte ne shoqëri.</p>

<ul style="list-style-type: none"> - Mbështetja e donatoreve për aktivitetin e OJQ-ve ne Shqipëri ne rënie - Aktiviteti i FSHDPAK mbështetet ne financimin e donatoreve/ financimet e Qeverise vetëm fragmentare 	<p>Sigurimi i mbështetjes se domosdoshme financiare për zbatimin e qëllimeve strategjike te organizatës</p>	<p>5.1 – Rritja e kapaciteteve te FSHDPAK ne mënyrë qe te rritet cilësia e shërbimeve.</p> <p>5.2 – Zhvillimi i marketingut dhe mundësia e gjetjes se fondeve për FSHDPAK.</p> <p>5.3 – Zhvillimi i Mirësia si je biznes social qe ka për synim mes te tjerash dhe një program gjenerimi te ardhurash për FSHDPAK.</p>
--	---	--



VI. PUBLIKIME TË FSHDPAK

Janar 2006 – Dhjetor 2006

1. Fletëpalosje “Zyra për ofrimin e shanseve te barabarta”, Shkodër.
2. Raporti vjetor FSHDPAK 2005 Shqip/Anglisht.
3. Ribotim i manualit te përdorimit te karriges Mirësia, program i FSHDPAK.
4. Raport” Studim dhe vlerësim i legjislacionit për aftësinë e kufizuar ne Shqipëri” Shqip/Anglisht.
5. Guide udhezuese mbi Ligjin Nr 8626, date 22/06/2000 per “Statusin e invalidit para dhe tetraplegjik” .
6. Guide udhezuese mbi Ligjin Nr. 9355, date 10/03/2005 “Per Ndihmen Ekonomike dhe sherbimet shoqerore”.
7. Përditësim i “Paketës ligjore në fushën e aftësisë të kufizuar”.
8. Fletë informuese mbi programin e asistencës ligjore dhe avokatisë për personat me aftësi të kufizuar.
9. Pakete informative mbi aftesine e kufizuar mendore.
10. Raport Kombetar “Respektimi i te drejtave te personave me aftesi te kufizuara mendore ne Shqiperi, ne fushen e kujdesit shendetesor, sherbimet shoqerore, arsim dhe punesim” Shqip/Ang.
11. Perktim dhe botim i Konventes se OKB mbi te drejtat e personave me aftesi te kufizuara.
12. Flete informative mbi Konventen per te drejtat e personave me aftesi te kufizuara.
13. Revista, “Sfida”, periodike e FSHDPAK, edicioni 21, 22,23.
14. 2 flete- info; a. Çfarë është terapia, disa tipe te ushtrimeve te terapisë ne paralizën cerebrale infantile. b. Dëmtimi ne shtyllën kurrizore.

